

**VENDIM**  
**Nr. 132, datë 16.8.2017**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “THE BLUE STAR” NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1 germa “e”; 13 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe neneve 15 dhe 19 të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.8.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “The Blue Star” sh.p.k., të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “The Blue Star” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar tërësisht.
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat , “b”, “c”, “e”) është plotësuar tërësisht.
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” “d”) është plotësuar tërësisht.
  - Dokumentacioni tekniko - ekonomik (neni 9, pika 4.8, germa “c”) është plotësuar tërësisht.
- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:
- Nenin 9, pika 2, germa “a” (akti i themelimit të shoqërisë);
  - Neni 9, pika 2, germa “d” (vërtetimi nga gjykata);
  - Neni 9, pika 4.8, germa “a”/”d”, sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar sipas viteve; germa “b”, kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti; do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “The Blue Star” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**